

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**Statut Themelimi i Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar**

Sot, me 12/03/2023, une, themeluesi Maksim Gjokutaj, atesia Idajet, amesia Lale, i datelindjes 20.10.1974, lindur ne Kuc Vlore, dhe banues ne Tirane ne adresen: Rruga "Muhamet Gjollesha"; Nd. 71; H. 20; Ap. 6; Njesia Administrative Nr.7; 1023 Tirane, me karte identiteti me numer personal H41020154T, po hartoj kete statut, me qellim krijimin e nje subjekti tregtar ne formen e nje shoqerie me perpjegjesi te kufizuar me emertimin "**EKMG INVEST**" SH.P.K.

**Me qellim formalizimin ligjor te kesaj shoqerie tregtare, po deklaroj kete status te kesaj shoqerie te re qe po formohet, status i cili do te normoje dhe rregulloje ligjerisht gjithe aktivitetin tregtar dhe ligjor te kesaj shoqerie qe po krijohet.**

**Ky statut, hartohet dhe bazohet ne Ligjin Nr. 9901 date. 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", i ndryshuar.**

**Statuti i kesaj shoqerie te re tregtare qe po formohet ne vazhdim te ketij akti do te quhet shkurtimisht "STATUT" dhe ka kete organizim dhe normin ligjor si me poshte.**

**KREU I  
HYRJE**

**Neni 1**  
**Data e Themelimit, Emri, Themeluesi, Selia, Kohezgjatja.**

Sot ne daten 12.03.2024, themelohet subjekti tregtare ne formen Shoqeri me perpjegjesi te kufizuar me emrin tregtar "**EKMG INVEST**" SH.P.K. Kjo shoqeri themelohet ne perputhje me Ligjin 9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" si dhe Ligjin Nr. 131/2015 "PËR QENDRËN KOMBËTARE TË BIZNESIT".

Kjo shoqeri krijohet nga nje ortak i vetem person fizik me emrin: Z. Maksim Gjokutaj, atesia Idajet, amesia Lale, i datelindjes 20.10.1974, lindur ne Kuc Vlore, dhe banues ne Tirane ne adresen: Rruga "Muhamet Gjollesha"; Nd. 71; H. 20; Ap. 6; Njesia Administrative Nr.7; 1023 Tirane, me karte identiteti me numer personal H41020154T, madhor dhe me zotesi te plotë juridike e per te vepruar.

Selia e Shoqerise me Pergjegjesi te kufizuar "**EKMG INVEST**" SH.P.K. eshte ne Tirane, ne adresen: Rruga " 5 MAJ", Kulla Nr. 1, Apartamenti 6, Tirane. Ajo gezon te drejten per te hapur filiale, dege, apo agjensi te tjera si brenda ashtu edhe jashte vendit.

Adresa e shoqerise per qellime komunikimi elektronik eshte si vijon: m\_gjokutaj@yahoo.com

Shoqeria me Pergjegjesi te kufizuar "**EKMG INVEST**" SH.P.K, krijohet per te ushtruar aktivitetin e saj per nje kohezgjatje mbi 10 vjet. Kjo shoqeri mund te zgjase afatin e veprimtarise se saj ose mund te mbylle aktivitetin e saj edhe para mbarimit te ketij afati, e realizuar kjo sipas dispozitave qe percaktohen ne kete statut, me vendim te Asamblese se



Ortakut te vetem dhe sipas kritereve qe percaktohen ne kuadrin ligjor mbi te cilin ajo krijohet, por edhe akte te tjera ligjore ne fuqi.

## Neni 2 Objekti

Shoqeria do te kryejë aktivitetin e saj tregtar dhe do te kete si objeët te aktivitetit te saj tregetr, ne fushat si mc poshtc:

- Ne fushen e ndertimit shoqeria do te kryeje: Studimin, projektimin, konsulencen, supermarrjen zbatuese dhe/ose investimin, sipas rastit, nepermjet realizimit me fonde publike dhe/ose jopublike te veprave me karakter shfrytezimi dhe/ose administrimi, publike dhe/ose private si: ndertimin e ndertesave publike dhe private, rrugeve, urave, tuneleve, mbikalimeve e nenkalimeve, autostradave, traseve hekurudhore, dhe te gjitha veprave te tjera madhore, ujesjellesave, Ujrale mbitokesore dhe nentokesore per energjine dhe telekomunikacionet, ndertimin dhe rehabilitimin e veprave ujitese, centralet, hidrocentrale, parqe te ndryshme elektrike nepermjet diellit ose eres, objektet turistike, objektet ushtarake, objektet e kultit, rrjetet inxhinierike, portet, aeroportet, objektet industriale, te gjitha restaurimet ne per gjithesi, rikonstruksione te veprave te artit, montimet e konstruksioneve metalike; germime e sistemime te dherave per ndertimin e objekteve te ndryshme ne fushen e ndertimit, ose te agro-kultures si vreshta planatacione pemesh ...etj, si dhe cdo ndertim tjeter i cili ne perfundim perben send te paluajtshem sipas Kodit Civil per shkak te trupezimit ne menyre te qendrueshme e te vazhdueshme me token ose ndertesen ku eshte vendosur.
- Ne fushen e minierave, shoqeria do te kryeje: Studimin, zbatimin, projektimin, konsulencen, supermarrjen zbatuese dhe/ose investimin, sipas rastit, per realizimin me fonde publike dhe/ose jopublike te minierave me karakter shfrytezimi dhe/ose administrimi publik dhe/ose privat si: ndertimin dhe shfrytezimin e minierave publike dhe private per te gjitha llojet e mineraleve, shfrytezimin e burimeve natyrore te ujrale minerale dhe termale; nxjerrja, prodhimi, perpunimi dhe tregtimi brenda vendit e mineraleve te paperpunuara dhe te perpunuara.
- Ne fushen e turizmit, shoqeria do te kryeje: Studimin, projektimin, konsulencen, supermarrjen zbatuese dhe/ose investimin, sipas rastit, per realizimin me fonde publike dhe/ose jopublike te infrastruktureve dhe/ose te pjeseve perberese te saj, per shfrytezimin njerezor me karakter pushues, argetues, edukues dhe/ose kurues, te burimeve natyrore, kulturore, mjedisore kurative, te Shqiperise dhe me gjere, per realizimin e hotelerise, fshatrave turistike, qendra turistike, krijimin e agjencive turistike... etj, dhe krijimin e faciliteteve dhe aksesoreve te nevojshem, si bar bufe-restorante, qendra estetike, palestra fitnesi, njesi te shitjeve te konfeksioneve dhe prodhimeve ushqimore e industriale.... etj, te kesaj natyre;
- Ne fushen e transportit, shoqeria do te kryeje: Studimin, projektimin, konsulencen, supermarrjen zbatuese dhe/ose investimin, sipas rastit, per realizimin me fonde publike dhe/ose jopublike te infrastruktureve dhe/ose te pjeseve perberese te saj, per transportimin publik dhe/ose privat te njerezve dhe mallrave si dhe tranzitimin e tyre per gjate territorit te Shqiperise



nepermjet transportit rrugor, hekurudhor, ajror, ujor, teleferik etj. Shoqeria gjithashtu do te kryeje dhe duke mos u kufizuar vetem ne, aktivitetet e meposhtme:

- Ngarkim dhe shkarkim te anijeve, pritje dhe levrim te ngarkesave nga dhe per ne anije; stivim, depozitim, transportim, etiketim, ambalazhim, lidhje, numerim, pritje, perpunim, dhe levrim i ngarkesave nga dhe neper anije.- Sipermarrje dhe realizimi i cfaredo lloj aktiviteti te ligjshem lidhur dhe ne sherbim te ngarkimit te shkarkimit te anijeve ne cdo vend ankorim, ne porte.
- Sipermarrje, pergatitje dhe realizim i procesit te ngarkimit dhe te shkarkimit te konteniereve, te mjeteve te tjera transportuese, te anijeve, ne interes dhe per llogari te pronarit te anjes, per gjithesisht te mjetit transportues, ne interes dhe per llogari te pronarit te ngarkeses dhe/ose te porositesit te automjeteve/ trenit, anjes apo porositesve te tjere te ligjshem.
- Sipermarrje dhe realizim i ndermjetesimit dhe transportit, ngarkimit dhe shkarkimit te mallrave me tren e automjete ne interes dhe per llogari te shoqerise dhe te Porositesve, persona te trete.
- Ngarkim dhe shkarkim i trenave; Pritje dhe levrim i ngarkesave nga/dhe per ne stacionet e destiguara; Stivim, depozitim, transportim, etiketim, ambalazhim, lidhje, numerim, pritje, perpunim dhe levrim i ngarkesave nga/ dhe per transport hekurudhor dhe tokesor; Sipermarrje dhe realizimi i puneve te ndermjetesimit, agjencise dhe transportit ne interes te vete shoqerise ose te paleve te treta porositeze.
- Ne fushen e mjedisit shoqeria do te kryeje: Studimin, projektimin, konsutencen, sipermarrjen zbatuese dhe/ose investimin, sipas rastit, per realizimin me fonde publike dhe/ose jopublike te mbrojtjes dhe/ ose permiresimit si dhe rehabilitimit te kushteve te mjedisit rrethues; perpunimin e mbetjeve urbane, toksike, radioaktive, teknologjike si dhe mbetje te cdo lloji tjeter, trajtimi i ujrate industriale, projektimin, mbikqyrjen ne fushen e kerkimit dhe shfrytezimit te lendet drusore, trajtimin dhe mbrojtjen e pyjeve, riaftesimin dhe trajtimin e tokave te kripura e kenetave si dhe cdo veprimitari qe ka rendesi per shoqerine.
- Ne fushen e prodhimit, ne fushen e sherbimeve, ne fushen e botimeve publikimeve dhe reklamave. Ne fushen e tregtise. Ne fushen e Telekomunikacionit. Ne fushen e Energjise, aktivitetin e tregtimit me pakice te karburanteve, mbajtjen e depozitave te karburanteve per efekt te aktivitetit te shoqerise per tregtimin dhe perdorimin e karburanteve per shkak te veprimtarise se saj. Qiradhenie, Bar-Restoran, Parkim, kend lojrash, qender argetimi per femije te te gjitha moshave, qender per zhvillim te lojrate sportive dhe jo sportive, zhvillim trajnimesh, kurse argetuese dhe edukative, sherbime pastrimi (perfshire edhe lavazh automjete).
- Ne fushen e prodhimit dhe te perpunimeve industrial mekanike dhe metalike, shoqeria do te kryej perpunime te ndryshme te metaleve dhe konstruksioneve te ndryshme metalike per qellime te ndertimit, te transoportit ne lidhje me tregetimin ne vend ose per eksport te metalave, konstruksioneve metalike, fibrave te ndryshme, pjesve te kembimit, ose cdo lloj tjeter te perpunimit, prodhimit dhe tregetimit te metaleve, sit e zakonshme dhe te metaleve te rralla ose te cmuara.



### **Neni 3 Detyrimet e Shoqerise**

Shoqeria me Pergjegjesi te kufizuar **“EKMG INVEST” SH.P.K**, per detyrimet qe do te lindin gjate aktivitetit te saj me te tretet per gjigjet vetem me pasurite e saj, te luajtshme, te paluajtshme, ose pajisje e makineri qe do te jene te rregjistruara ne emer te saj. Ortaket e kesaj shoqerie nuk per gjigjen per detyrimet e kesaj shoqerie me pasurite e tyre qe nuk jane futur ne kapitalin e kesaj shoqerie.

### **KREU II Kapitali**

### **Neni 4 Kapitali themeltar**

- Kapitali themeltar fillestar i shoqerise eshte 100.000 Leke, i ndare ne 100 pjese, me vlore nominale 1.000 leke secila. Pjesemarrja e themeluesit ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributin e tij ne shoqeri, dhe eshte i ndare si me poshe:
- Ortaku i vetem themelues i shoqerise **Z. Maksim Gjokutaj**, eshte zoterues i te gjitha kuotave me vlore te per gjithshme qe perben 100% te kapitalit themeltar te shoqerise.

### **Neni 5 Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit te shoqerise**

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nenshkrimive te pjeseve te kapitalit themeltar per kontributet ne para dhe me ane te kontributeve ne natyre, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e nje eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kerkeses se administratorit.

Ne asje rast shumica nuk mund te detyroje nje ortak per te rritur angazhimin e tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakeve, e cila merr vendim me te njejtat kushte qe kerkohen per ndryshimin e statutit.

Ne te gjitha rastet zvogelimi i prek ortaket ne te njejten mase ndaj pjeseve te kapitalit qe perfaqesojne.

### **Neni 6 Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit te nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar e te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

a.) kontributit ne kapitalin e shoqerise;

- b.) shitblerjes;
- c.) trashegimise;
- d.) dhurimit;
- e.) çdo menyre tjeter te parashikuar me ligj.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme ndermjet ortakeve, per sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.

Pjeset e kapitalit themeltar jane lirisht te transferueshme me rruge trashegimie.

### **KREU III** **ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE**

#### **Neni 7** **Organi Vendimmarres**

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendim-marres i shoqerise.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteve te percaktuara ne ligj.

Asambleja e per gjithshme e ortakeve eshte per gjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine per ceshtjet e me poshtme:

- a.) percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
- b.) ndryshimet e statutit;
- c.) emerimin e shkarkimin e administrates, sipas rregullave ligjore ne fuqi;
- d.) emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
- dh.) percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat "c" dhe "d" te kesaj pike;
- e.) mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire per gatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise.
- f.) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise.
- h.) zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit.
- i.) pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre.
- j.) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve.
- k.) riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.
- l.) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese.
- ll.) ceshtje te tjera te parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund te perfaqesohet ne asamblene e per gjithshme, ne baze te nje autorizimi nga nje ortak tjeter apo nga nje person i trete.

Administratori i shoqerise nuk mund te veprojne si perfaquesues i ortakeve ne asamblene e



pergjithshme.

Autorizimi mund te jepet vetem per nje mbledhje te asamblese se pergjithshme, e cila perfshin edhe mbledhjet vijuese me te njejtin rend dite.

### Neni 8

#### **Menyra e Thirrjes se Mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme.**

Asambleja e pergjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose, nese parashikohet nga statuti, me njoftim nepermjet postes elektronike. Njoftimi me shkrese apo me mesazh elektronik duhet te peimbaje vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites e t'u dergohet te gjithe ortakeve, jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.

Kur asambleja e pergjithshme nuk eshte thirrur sipas pikes 1 te ketij neni, ajo mund te marre vendime te vlefishme vetem nese te gjithe ortaket jane dakord, per te marre vendime, pavaresisht parregullsise.

### Neni 9

#### **Kuorumi**

Ne rastin e marrjes se vendimeve, qe kerkojne nje shumice te zakonshme, asambleja e pergjithshme mund te marre vendime te vlefishme vetem nese marrin pjese ortaket me te drejte vote, qe zoterojne me shume se 40 per qind te kuotave.

Ne rastin kur asambleja e pergjithshme duhet te vendose per ceshtje, te cilat kerkojne shumice te kualifikuar sipas nenit 87 te ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ajo mund te marre vendime te vlefishme vetem, nese ortaket qe zoterojne me shume se gjysmen e numrit total te votave, jane te pranishem personalisht, votojne me shkrese, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve te pikes 3 te nenit 88 te ketij ligji.

Nese asambleja e pergjithshme nuk mund te mblidhet per shkak te mungeses se kuorumit te permendur me lart, asambleja mblidhet perseri jo me vone se 30 dite, me te njejtin rend dite.

### Neni 10

#### **Marrja e vendimeve**

Asambleja e pergjithshme vendos me tri te katertat e votave te zoteruesve te kapitalit, te ortakeve pjeseman'es, per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

Asambleja e pergjithshme vendos me shumicen e votave te ortakeve pjesemarres, per ceshtje te tjera si:

- a.) percaktimi i politikave tregtare te shoqerise;
- b.) emerimin dhe shkarkimin e administratoreve;
- c.) emerimin e shkarkimin i likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;



d.) percaktimin e shperblimeve;  
dh.) mbikeqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire perqatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;  
e.) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;  
f) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;  
Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasqyuar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

### **Neni 11 Perjashtimi nga e Drejta e Votes**

1. Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja e Pergjithshme merr vendim per:
  - a.) vleresimin e veprimtarise se tij;
  - b.) shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij;
  - c) ngritjen e nje padie ndaj tij nga shoqeria;
  - d.) dhenien ose jo te perfitimeve te reja.
2. Kur ortaku perfaqesohet nga nje perfaqesues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin konflikt interes, ashtu si dhe ortaku, te cilin perfaqeson.

### **Neni 12 Administrimi**

Asambleja e Pergjithshme emeron nje ose me shume persona fizike si administratore te shoqerise. Afati i emerimit, eshte 5 vjet, me te drejte riperteritjeje.

Emerimi i administratoreve prodhon efekte pas regjistrimit ne Qendren Kombetare te Biznesit. Administratoret e nje shoqerie tregtare te cilet, sipas percaktimit te nenit 207 te ketij ligji, nuk mund te emerohen si administratore te nje shoqerie te kontrolluar e anasjelltas. Cdo emerim i bere ne kundershtim me keto dispozita eshte i pavlefshem.

Personi i meposhtem caktohet si Administrator i pare i shoqerise deri ne emerimin e tyre nga mbledhja e pare e Asamblese se Pergjithshme.

*Te dhenat e identifikimit:*

**Maksim Gjokutaj ID:** Numer personal H41020154T Adresa: Rruga "5 MAJ"; Kulla Nr. 1; Ap. 6, Tirane. Specimenet e nenshkrimit:

**Administrator**



## Neni 13

### Kompetencat e Administratorit

Administratori ka te drejte dhe detyrohet te:

- a.) te kryeje te gjitha veprimet e administrimit te veprimtarise tregtare te shoqerise, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga asambleja e per gjithshme;
- b.) te perfaqesoje shoqerine tregtare ne marredhenie me te tretet;
- c.) te kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te shoqerise;
- d.) te per gatise dhe nenshkruajne bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, ti paraqes keto dokumente perpara asamblese se per gjithshme per miratim;
- dh.) te krijoje nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rr Ethanat, qe kercenojne mbarevajtjen e veprimtarise dhe ekzistencen e shoqerise;
- e.) te kryeje regjistrimet dhe dergojne te dhenat e detyrueshme te shoqerise, sic parashikohet ne ligjin per Qendren Kombetare te Biznesit;
- f.) te raportoje perpara asamblese se per gjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarine e shoqerise tregtare;
- h.) te kryeje detyra te tjera te percaktuara ne ligj dhe ne statut.
- j.) te hape dhe te administroje per llogari te shoqerise prane bankave te nivelit te dyte ne Shqiperi ose jashte saj llogari bankare, t'i administrojë ato dhe te firmosi aktet dhe shkresat e ndryshme bankare per transferta ose pagesa te ndryshme qe kryen shoqeria per shkak te veprimtarise se saj;

Administratori eshte i detyruar te therrasë Asamblene e Pergjithshme, ne rastet kur:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.
- shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjeter aktive, te cilat kane nje vlore me te larte se 5 % te aseteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.
- shoqeria, brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj, propozon te bleje nga nje ortak pasuri, qe kane vlore me te larte se 5 % te aseteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara,

Nese asambleja e per gjithshme emeron me shume se nje administrator, ata e administrojne bashkerisht shoqerine.

Asambleja e per gjithshme mund te shkarkoje administratorin ne cdo kohe me shumice te zakonshme.

Padite, qe lidhen me shperblimin e administratorit, ne baze te marredhenieve kontraktore me shoqerine, irregullohen sipas dispozitave ligjore ne fuqi.



## **Neni 14** **Pergjegjesite e Administratorit**

Administratori eshte pergjegjes individualisht, ndaj shoqerise ose ndaj te treteve, per shkelje te ligjeve, per shkelje te statutit, apo per faje te kryera gjate administrimit te shoqerise.

Pasojat e marreveshjeve te pamiratuara nga asambleja qe i sjellin dem shoqerise, i ngarkohen administratorit dhe ortakut qe ka bere maneveshjen, per te perballuar ne menyre individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat perkatese.

Pervec sa eshte parashikuar ne dispozitat e pergjithshme te detyrimit te besnikerise, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 te ligjit “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare“, administratori detyrohet:

- a) te kryeje detyrat e tij te percaktuara ne ligj dhe ne statut ne mirebesim e ne interesin me te mire te shoqerise ne teresi, duke i kushtuar vemendje te vecante ndikimit te veprimtarise se shoqerise ne mjesid;
- b.) te ushtroje kompetencat qe i njihen ne ligj dhe ne statut vetem per arritjen e qellimeve te shoqerise e te percaktuara ne keto dispozita;
- c.) te vleresoje me pergjegjesi ceshtjet, per te cilat merret vendim;
- d.) te parandaloje dhe menjanoje rastet e konfliktit, prezent apo te mundshem, te interesave personale me ata te shoqerise;
- dh.) te ushtroje detyrat e tij me profesionalizinin dhe kujdesin e nevojsphem.
- e.) Administratori, gjate kryerjes se detyrave te tij, per gjigjen ndaj shoqerise per cdo veprim ose mosveprim, qe lidhet ne menyre te arsyeshme me qellime te shoqerise tregtare, me perjashtim te rasteve kur, ne baze te hetimit dhe vleresimit te informacioneve perkatese, veprimi ose mosveprimi eshte kryer ne mirebesim.
- f.) Nese administrateri vepron ne kundershtim me detyrat dhe shkel standarde profesionale, sipas pikave 1 e 2 te ketij nenit, eshte i delyruar t'i demshperbleje shoqerise demet, qe rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kaloje cdo fitim personal qe ata apo personat e lidhur me ta kane realizuar nga keto veprime te parregullta. Administratori ka barren e proves per te vertetuar kryerjen e detyrave te tyre ne menyre te rregullt e sipas standardeve te kerkuara. Kur shkelja eshte kryer nga me shume se nje administrator, ata per gjigjen ndaj shoqerise ne menyre solidare.

Ne menyre te vecante, por pa u kufizuar ne to, administratori eshte i detyruar t'i demshperbleje shoqerise demet e shkaktuara, nese, ne kundershtim me dispozitat e ligjit “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare” kryen veprimet e meposhtme:

- a.) u kthen ortakeve kontributet;
- b.) u paguan ortakeve interesa apo dividende;
- c.) u shperndan aktivet shoqerise;
- d.) lejon qe shoqeria te vazhdoje veprimtarine tregtare, kur ne baze te gjendjes financiare, duhej



te parashikohej qe shoqeria nuk do te kishte aftesi paguese per te shlyer detyrimet; dh.) jep kredi.

Pervec padise per shlyerjen e demit qe i ngarkohet personalisht administratorit, ortaket individualisht ose se bashku, kane te drejte te ngritjen e kerkese padise kunder administratorit.

Paditesit kane te drejte te ndjekin ne rruge ligjore shlyerjen e plete te demit qe i eshte shkaktuar shoqerise, perfshire edhe demshperblimin financiar, nese eshte e nevojshme. Asnje vendim i asamblese nuk mund te ndaloje ngritjen e kerkese padise kunder administratorit per gabimet e kryera prej tij gjate ushtrimit te detyres.

#### **KREU IV** **Viti finanziar – ekspertet**

##### **Neni 15** **Viti Financiar**

Viti finanziar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare finanziar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbylljet me 31 Dhjetor.

##### **Neni 16** **Eksperet**

Eksperti ka per detyre qe te kontrolloje te gjithe dokumentacionin kontabel te veprimtarise ekonomiko-tregtare te shoqerise, ate gjithe-vjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike te ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer nje gje te tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.

Ne perfundim te kontrollit, eksperti kontabel i autorizuar percatit reportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit te bilancit financial' vjetor si dhe ate per kontrollet periodike te ushtruara, te cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e te drejtes vendimore qe ka.

##### **Neni 17** **Marredheniet e punes dhe sekreti i tyre**

Per nevoja te funksionimit dhe mbarevajtjes se saj, shoqeria ka te drejte te punojse persona te ndryshem. Marredheniet e punes se Shoqerise me personat e punesar rregullohen nepermjet kontrates se punes. Per çeshtjet qe kjo kontrate nuk i parashikon zbatohen dispozitat perkatese legjislacionit Shqiptar ne fuqi.



Te gjithe te punesuarit ne Shoqeri jane te detyruar te ruajne sekretin e punes se Shoquerise, ky detyrim vazhdon per nje periudhe 5 – vjecare edhe pas largimit te tyre nga kjo Shoqeri.

**KREU V**  
**Prishja - Riorganizimi i Shoquerise**

**Neni 18**  
**Prishja dhe likuidimi**

Shperndarja ose prishja e shoquerise mund te behet ne cdo kohe:

- a.) kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj;
- b.) me vendim te Asamblese se Ortakeve;
- c.) me hapjen e procedurave te falimentimit;
- d.) nese nuk ka kryer veprimitari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimitarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr. 9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit";
- dh.) me vendim te gjykates;

Ne kete rast Ortaket merrin vendim me shkrim ne te cilin parashikojne menyren e likuidimit te shoquerise, duke caktuar nje apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument te nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".

Prishja e shoquerive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likuidimit ne gjendjen e aftesise paguese, me perjashtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emeruar nga Ortaket.

Nese Ortaket nuk marrin nje vendim per emerimin e likuiduesve, brenda 30 diteve pas prishjes, cdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykates, per te caktuar nje likuidues.

**Neni 19**  
**Riorganizimi i shoquerise, bashkimi –ndarja**

Shoqeria mund te ndahet, bashkohet sipas Vendnnit te Mbledhjes se Pergjithshme te Asamblese se Ortakeve, ne perputhje me dispozitat ligjore te parashikuara ne Pjesen IX te Ligjt 9901 date 14.04.2012 "Per tregtaret dhe shoquerite tregtare".

**Neni 20**  
**Baza Ligjore**

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Persa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjt "Per tregtaret dhe



shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe cfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise. Shoqeria Tregetare "**EKMG INVEST**" SH.P.K, deklarohet e krijuar ne zbatim te plete te normave qe permban ky Statut, Akti Themelimit te saj si dhe normat e legislacionit Shqiptar ne fuqi. Shoqeria fiton zotesine per te vepruar me regjistrimin e saj prane Qendres Kombetare te Biznesit.

**Neni 21**  
**Mosmarreveshjet**

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per cdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

***ORTAKET E SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR***  
***"EKMG INVEST" SH.P.K.***

*Maksim Gjokutaj*

